

Emër Mbiemër: Bardhyl Golemi
Datëlindje: 11.05.1932
Vendlindje: Dhrovjan, Sarandë, Shqipëri
Viti i zgjedhjes: 1999
Seksioni: Shkencat natyrore dhe teknike
Gjuhët: Frëngjisht



Kontakt:

Adresa: Sheshi Fan Noli Nr 7, Tiranë
Telefon: +355 692249910
Email: bardhylgolemi@live.com
Faqe zyrtare: www.akad.gov.al

CV e shkurtër

Lindi në Dhrovjan, Sarandë. Ka kryer shkollën e mesme “Ali Demi “ në Vlorë, me “Medaljen e Artë”, Institutin e Lartë Politeknik në Tiranë me cilësimin «Shkëlqyer», një specializim në “Grand Ecol d’Electricite”, Docent (1975), Doktor i Shkencave (1979), Profesor (1981), Anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (1999).

Ka punuar si ligjërues dhe drejtues në Universitet, në Akademinë e Shkencave, dhe në Ministrinë e Arsimit (Zv.Ministër), anëtar i disa Senateve dhe Këshillave Shkencore të të gjitha niveleve. Kryetar i Komisionit Kombëtar të UNESCO-s për Shqipërinë (1982-1990). Themelues dhe drejtues për 15 vite i Katedrës së Elektronikës. Ka kontribuar në formimin e 75 gjeneratave të inxhinierëve në Shqipëri dhe në Kosovë. Është autor i shumë kurikulave universitare dhe pasuniversitare, ka kontribuar në shkollën doktorale të inxhinierisë elektrike, ka udhëhequr diploma universitare e pasuniversitare, disa prej të cilave për doktor të shkencave, studime dhe projekte. Ka kontribut në studimin e problemeve të shkollës dhe të shkencës, në konceptimin dhe realizimin e mjaft aktiviteteve kombëtare për pedagogjinë e zbatuar, referime e shkrime në Konferencën Ndërkombëtare të UNESCO-s. Për 10 vjet, ka mbajtur ligjërata në Universitetin e Prishtinës për “Teorinë dhe Sintezën e Qarqeve”. Ka qenë anëtar i redaksisë qendrore të “Fjalorit Enciklopedik Shqiptar” (1985). Ka botuar me bashkëautor “Zhvillimi i Arsimit të Lartë në Shqipëri” (1986), “Shkolla Shqiptare e Elektroteknikës (2004), “Universiteti I Tiranës 1957-2007”, “Eksperimenti dhe Pedagogjia e tij në shkollën bujqësore” (Rev. Pedagogjike nr3 1988), “Arsimi Profesional , pamje dhe perspektiva” (Rev. Pedagogjike nr2 1989, Ref. në Konf. Ndërkombëtare të UNESCO-s në Poitje 2001) etj.

Ka kryer studime dhe referime në fushën e lëkundjeve elektrike, të teorisë së Qarqeve Elektrike. Ka mjaft artikujtë botuar në Buletinet Shkencore të Universitetit, , si “Metodikë për zgjidhjen e një ekuacioni diferencial jo linear të rendit” (B.SH.N. nr 31986), “Shndrimi i Spektrit diskret nga një element

jolinear" (B.SH.T nr.1 1976), "Përfthimi i modelit matematik për disa qarqe lëkundëse tre fazore" (B.SH.T nr 3 1982), "Vështrime relativiste për valën EM plane" prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare të Metsovo në Greqi (1997) dhe referuar ne buletin përkatës etj.

Ka disa botime universitare (6) të përmirësuara në vite për «Bazat Teorike të Elektroteknikës», "Sinteza e Qarqeve Elektrike" (1982), "Fusha elektromagnetike" (adoptim), "Bazat teorike të Elektronikës" në tre vëllime (1500 faqe) në nivelin e një traktati (2001).

Monografitë : "Lëkundjet në rrjetin 35 KV nga transformatorët e tensionit", Ka kontribuar për trajtimin e problemeve të sotme të bioelektromagnetizmit në monografitë "Fusha Elektromagnetike dhe Shëndeti" (2004), "Vala, celulari dhe shëndeti"(2006) me bashkëautor, "Njeriu elektromagnetik në mjedis elektromagnetik" (2014), në Studime për koridoret elektromagnetikë të linjave të TN në Shqipëri Është në bordin drejtues të revistës Shkencore ndërkombëtare "JAE" dhe në bordin drejtues të revistës shkencore "JNTS" të A.SH. të Shqipërisë

Mban vlerësimet : "Qytetar nderi i Vlorës", "Urdhëri Naim Frashëri kl. II", "Urdhëri Flamuri i Kuq i Punës Kl.II", "Çmimi i Republikës kl.I"